



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 3046/c Prot.

Vlorë më 26.11 2025

VENDIM

Nr. 113 datë 26.11.2025

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STDUDIMIT, MASTER I SHKENCAVE NË
"SISTEMET E AVANCUARA TE PRODHIMIT" PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja 'dh' dhe nenit 75 të ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja 'ë' dhe nenit 59 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; neni 13, pika 22, neni 55 dhe 69 të Rregullores së Brendshme të UV-së; Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve" (i ndryshuar); VKM-së Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar; si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore përcjellë me shkresën nr. 714/1 Prot., datë 26.11.2025; dhe relaconit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike, përcjellë me shkresën 2013/4 prot., datë 26.11.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.11.2025,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit i Inxhinierive dhe Teknologji Detare, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, për hapjen e programit të ri të studimit, Master i Shkencave në "Sistemet e Avancuara të Prodhimit", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike dhe Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliq

A. Saliq

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

